



# CBC ZOOM

## Bjeshët e Nemuna - përvojë e personalizuar

Rajoni ndërkufitar i *Bjeshkëve të Nemuna* u promovua intesivisht dhe gjerësisht nga dy projekte: projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës* i zbatuar nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije, Organizata turistike e Plavës, Agjencia për Zhvillim Rajonal – Perëndim (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës dhe projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* i zbatuar nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim – KADC, Shërbimi i Shpëtimit Malor i Malit të Zi dhe Shoqëria Alpiniste "PASHTRIKU". Të dy projektet zbatuan një sërë aktivitësh në zonën e Bjeshkëve të Nemuna dhe kontribuan në përmirësimin e ofertës së përgjithshme turistike dhe rritjen e sigurisë së turistëve në rajon.

Një nga rezultatet kryesore të projekteve dhe shembulli i sinergjisë së këtyre dy projekteve është ueb portali që u krijua dhe që promovon këtë rajon. Ueb portali i përbashkët është krijuar për të sublimuar në një vend të gjithë informacionet e disponueshëm në lidhje me këtë rajon.



Portali përmban informacione për ofertën turistike lidhur me pushime aktive, përfshirë këtu vendet për të vizituar, informacione, kontakte, harta etj. Për më tepër, aplikacionet Android dhe iOS janë krijuar dhe përmbajnë të gjitha të dhënat përkatëse për turistët/vizitorët e paraqitur në një ndërfaqe miqësore për përdoruesit. Para se të planifikoni udhëtimin tuaj, sigurohuni që të shikoni portalin [këtu](#).



Portali ofron informacion mbi aktivitetet në natyrë si ecja në natyrë, ku mund të zgjidhen opsione të ndryshme, nga shtigjet e njohura *Via*



*Dinarica dhe Peaks of the Balkans* ose disa më pak sfiduese, si dhe shtigjet e reja të ecjes të zhvilluara nga këto dy projekte. Për më tepër, një sërë shtigjeve për biçikleta me peizazhe spektakolare janë të disponueshme nga ato më sfiduese, deri tek ato që janë më të lehta.



Ka gjithashtu informacione për lokacionet që ofrojnë mundësi ngjitjeje. Për të rritur sigurinë e turistëve dhe duke pasur parasysh se disa nga këto shtigje malore kalojnë nëpër një zonë ndërkufitare, alpinistët që planifikojnë të kalojnë kufirin këtu duhet të informojnë paraprakisht policinë kufitare dhe portali ofron [udhëzime dhe procedura](#) të qarta të cilat duhet ndjekur.



## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### Konferenca mbi bimët aromatike dhe medicinale u mbajt në Plavë

Konferenca e parë e projektit të financuar nga fondet e BE-së "Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit" u mbajt në Plavë, me datë 28 prill të vitit 2022. Ky projekt po zbatohet nga komuna e Plavës bashkë me Bashkinë Tropojë, OJF Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik dhe OJQ Alpet Shqiptare.



Projekti synon të rrisë kapacitetet e popullsisë në zonën ndërkufitare të Tropojës dhe Plavës mbi përdorimin e bimëve aromatike dhe medicinale, mënyrat e mbledhjes dhe përdorimit të tyre të qëndrueshëm dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve publike për monitorimin e llojeve të bimëve aromatike dhe medicinale.



### U mbajt punëtorja për studentët

Si pjesë e fushatës për rritjen e ndërgjegjimit në projektin "Fatkeqësitë nuk njohin kufinj 2" Prefektura e Shkodrës, në bashkpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe drejtoritë respektive të shkollave, organizoi 12 punëtori dhe ligjerata informuese në datat 22-23 shkurt të vitit 2022, me 133 studentë dhe mësues nga shkollat e zonave të rrezikuara nga zjarret dhe përbytyet e rajonit Shkodër. Qëllimi i këtyre sesioneve informuese ishte informimi i studentëve mbi veprimet që duhen bërë dhe që mund t'i ndihmojnë ata dhe familjet e tyre në rastet e fatkeqësive natyrore, rritja

e ndërgjegjimit mbi reduktimin e rrezikut të fatkeqësive, me theks tek zjarret dhe përbytyet.



### Liçeni i Shkodrës pa ndotje kimike

Projekti "Liçeni i Shkodrës pa ndotje kimike – zgjidhja" që po zbatohet nga Qendra për hulumtime toksikologjike Mal i Zi (CETI), Universiteti i Tiranës, Shqipëri dhe Asocacioni Green Centre, Shqipëri, vazhdon me organizimin e aktiviteteve promovuese. Konkretisht, informacione mbi planin e aktiviteteve u ndanë me mediat malazeze.



Vidoje Petriçiq, drejtore ekzekutive e CETI, falenderoi BE-në dhe programin BNK Mal i Zi – Shqipëri për mundësinë e zbatimit të këtij projekti. "Në mënyrë që të mbrojmë biodiversitetin e liçenit të Shkodrës, është e nevojshme të ndërtohet bashkpunimi i ngushtë dhe i vazhdueshëm ndërmjet njerëzve në dy anë e kufirit. Ky lloj bashkpunimi ka filluar pikërisht me zbatimin e këtij projekti dhe është i rëndësishëm, duke mbajtur në konsideratë faktin që, hetimet për ndotjen kanë qenë të pamjaftueshme.

Ky projekt synon të dakortësojë zbatimin e aktiviteteve afatgjata, të kryej vlerësimin e rrisht mbi mjedisin, të ndotjes në liçenin e Shkodrës dhe të përcaktojë hot-spotet e ndotjes. Ekipi i projektit po punon intensivisht mbi vlerësimin e rrezikut mjedisorë të ndotjes kimike në liçenin e Shkodrës.

Danijela Sukoviq, menaxhere e projektit nga CETI deklaroi se "Në anën tonë, ne po diskutojmë për 10 pika hot spote, ndërsa nga ana shqiptare për 4 të tilla. Në total 14 hot spote janë mjaftueshëm për autoritetet dhe me ndihmën e tyre, ne do japim një panoramë të plotë të situatës pas ekzaminimit të analizave. Ky projekt ka shumë aspekte kërkimore por nuk është si një proces kërkimi klasik.

## FAKTE - Solution

Ekipi i projektit është duke bërë promocion të mirë të projektit dhe rezultateve që synojnë të arrijnë. Si pjesë e aktiviteteve, është krijuar një web faqe me informacionet kryesore dhe mund të aksesohet tek <http://solutionmne-al.eu/>


### Punë për të rinjtë: Kampet e inovacionit u organizuan në Beçiqi dhe Shkodër

Në kuadër të programit për Kampet e Inovacionit, pjesë e projektit Punë për të Rinjtë, gjatë muajit mars u organizuan 6 sesione informuese, me synim inkurajimin e të rinjve për të marrë pjesë në projekt.



Sesionet informuese u mbajtën në Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Tuz dhe Podgoricë, si dhe online, gjatë të cilave mbi 100 të rinj nga këto bashki mësuuan më shumë mbi programin, aktivitetet dhe procesin e aplikimit.

Pas fushatë informuese, dy kampe inovacioni u organizuan në Beçiqi dhe Shkodër. Kampet ishin programe intensive për të fituar aftësi praktike, ku individëve dhe ekipeve të përzgjedhura iu dhanë njohuritë e nevojshme për zhvillimin e aftësive të sipërmarrjes dhe ideve të biznesit bazuar në nevojat dhe aftësitë e komunitetit lokal.



Projekti Punë për të rinjtë zbatohet nga Partnerët Shqipëtarë për Ndryshim dhe Zhvillim, Shqipëri, Asociacioni për Demokraci dhe Prosperitet – Zid (Mal i Zi) dhe OJF Intelektualët e Rinj Shpresë, Shqipëri.

### Trajnimi për mentorë u mbajt në kuadër të projektit A.C.C.E.N.T.

Projekti A.C.C.E.N.T. – "Aksesi, Ndërgjegjia Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri" po zbatohet nga Caritas i Kryepeshkopatës së Tivarit (Mal i Zi), Caritas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë (Shqipëri) dhe Asociacioni i Paraplegjikëve Tivar. Si pjesë e projektit A.C.C.E.N.T., nëpërmjet të cilit u zhvillua programi i mentorimit, u organizua një trajnim 3 ditorë për mentorët në Avala Hotel në Budva. Trajnimi i drejtuar nga trajnerja Danka Qetkoviq, mbledhi 11 mentor, të cilët do punojnë bashkë me personat me aftësi të kufizuara, gjatë periudhës në vijim.



Qëllimi i trajnimit ishte rritja e aftësive bazike të mentorimit për të punuar me personat me aftësi të kufizuara, ku pjesëmarrësit kanë mundësi të mësojnë të adoptojnë punën me vendin e punës, hapat e mentorimit si dhe karakteristikat kryesore të mentorimit të sukseshëm. Për më tepër, nëpërmjet shembujve praktikë dhe ushtrimeve, pjesëmarrësit u njohën me konceptin dhe modelin e paaftësisë dhe terminologjinë e saktë lidhur me personat me aftësi të kufizuara. Trajnimi u ndoq nga koordinatori i aktiviteteve të organizatës Caritas i Kryepeshkopatës së Tivarit, **Marko**

Djelovic, si dhe drejtori i Asociacionit të Paraplegjikëve Tivar, Slavko Vucicevic.



### Mali Zi dhe Shqipëria drejt Zero Mbetje

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, ekipi i projektit Zero Mbetje ka vijuar me organizimn e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe takimet edukative me përfaqësues nga komunitetet dhe shkollat në Margegaj dhe Guci. Qëllimi i tyre ishte, dhënia e mesazheve kyç mbi projektin dhe edukimi i popullsisë lokale mbi parimet e Zero Mbetje.



Procesi u mbështet nga Z. Enzo Favoino, koordinatori shkencor nga Zero Mbetje Europa, i cili ka sjellë njohuritë dhe eksperiencat nga vende të ngjashme të BE që aplikojnë praktikatat e Zero Mbetjeve në menaxhimin e mbetjeve. Fushata u mbështet nga anëtarët e Bordeve Këshillimore Zero Mbetje, të cilët, kanë përcaktuar edhe hapat e mëtejshëm në zbatimin e projektit, disa prej të cilëve janë ndarja e mbetjeve dhe fushatat e prastrimit.



### Rrugët drejt Zhvillimit të Karrierës

Gjatë gjithë aktiviteteve të tij, ekipi i projektit "Rrugët drejt Zhvillimit të Karrierës", ka vendosur të rinjtë në qendër të vëmendjes. Një vizitë studimore u organizua me 50 të rinj nga Ulqini në Universitetin "Donja Gorica" (UDG) në Podgoricë. Të rinjtë nga Ulqini, patën rastin të njihen me një filozofi të veçantë biznesi që promovon ky universitet. Në qendër të kësaj vizite ishte "Foleja e sipërmarrësve" që operon brenda këtij institucioni për të inkurajuar energjitë kreative dhe aftësitë e të rinjve në krijimin e ideve të sukseshme të biznesit.



Në vazhdim, gjatë muajit Shkurt 2022, u organizuan 3 kurse profesionale për 50 të rinj dhe secili prej tyre pati mundësi të zgjidhte mes 3 kurseve të ofruara, Aftësimi Digjital, Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing në fushën e turizmit, kurse, ku parimet e trashigimisë kulturore dhe mikëpritjes në sektorin e turizmit janë ndërthurur me guidat turistike.



Kurset u zgjodhën bazuar në të dhënat e kërkimit të realizuar paraprakisht nga vet të rinjtë, rezultatet e të cilëve treguan se, punëdhënësit janë të interesuar për punonjës që kanë njohuri nga kurset e mësipërme. Gjithashtu, në 3 Mars 2022, në Ulqin, u mbajt një sesion trajnimi me të rinjtë dhe një cikël special i kurseve profesionale po organizohet në fushat e marketingut digjital, menaxhimi sketorial dhe shoqërimi në udhëtim.



## Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

### Transhumance - ofertë e re turistike në Kosovë dhe Mal të Zi

Projekti është udhëhequr nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK në partneritet me Agjencinë Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije. Pas një sërë aktiviteteve që synojnë mbështetjen e popullatës lokale me pajisje dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre, partnerët e projektit po promovojnë rezultatet e projektit.



Në kuadër të fushatës, oferta e re turistike në Istog dhe Pejë po promovohet përmes kasolleve të thjeshta dhe autentike të barinjve dhe kontakteve të personave që ofrojnë këtë lloj shërbimi. Shikoni ofertën e re turistike [këtu](#).



### CARES 2 - Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2

Projekti CARES 2 – Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2 i cili zbatohet nga Fondi për zhvillimin e Veriut të Malit të Zi- FORS Mali i Zi dhe Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave – ECMI Kosovë vazhdon me aktivitetet e veta. Gjatë javës 17-23 janar të vitit 2022, projekti shënoi javën kushtuar parandalimit të kancerit të qafës së mitrës. Në njoftimet e tyre theksohej se të dhënat në nivel ndërkombëtar tregojnë se kjo sëmundje është në vendin e dytë të prevalencës kur bëhet fjalë për sëmundjet malinje të grave, menjëherë pas kancerit të gjirit. *Më së shpeshti shfaqet tek gratë e moshës 40 deri në 45 vjeçare, por kufiri kur bëhet fjalë për sëmundjen po lëviz gjithnjë e më poshtë.* Sipas Agjencisë


Ndërkombëtare për Hulurtime mbi Kancerin, njoftuan që 113 gra u sëmurën me këtë sëmundje në Mal të Zi në vitin 2020.

## Ključ je u redovnim pregledima



Ata theksuan se vlerësohet se 30 deri në 40 për qind e kancereve të qafës së mitrës mund të parandalohen duke reduktuar ekspozimin ndaj këtyre faktorëve të rrezikut. Ata shtuan se është veçanërisht inkurajuese kur bëhet fjalë për këtë lloj kanceri që mund të zbulohet herët përmes programeve të organizuara të ekzaminimeve që synojnë zbulimin e hershëm dhe trajtimin e tij në kohë. Përveç edukimit mbi një stili jetese të shëndetshëm, kontrollet e rregullta janë arma më e mirë parandaluese. Më shumë informacion në dispozicion [këtu](#).

## PRAXIS



Konsorciumi i ekipit të projektit, udhëhequr nga Caritas Kosova në bashkëpunim me Caritas Mali i Zi, OQAKP Gjon Nikolle Kazazi nga Gjakova dhe komuna e Beranes, janë duke zbatuar projektin PRAXIS që synon të nxisë punësimin e të rinjve nga zonat e synuara në rajonin ndërkufitar dhe pritjet të rezultojë në rritjen e kapaciteteve për punësim dhe mundësi punësimi për nxënësit, studentët dhe të rinjtë e papunësuar.

Gjatë kësaj periudhe, ekipi i projektit zhvilloi publikimin [Studimi i praktikave më të mira mbi Udhëzimin dhe Këshillimin lidhur me Karrierën e të Rinjve në rajonin ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë](#). Publikimi ofron informacione kyçe lidhur me situatën në drejtimin dhe këshillimin në

karrierë në Mal të Zi dhe Kosovë. Për më tepër, publikimi ofron një pasqyrë të praktikave më të mira në rajon dhe informacion mbi mbështetjen për nxënësit, studentët dhe mësuesit.

## Trashëgimia kulturore - Thesar i rajonit ndërkufitar

Komunat e binjakëzuara, komuna e Pejës dhe komuna e Gucisë, me forca të përbashkëta po zbatojnë projektin *Trashëgimia kulturore – Thesari i Rajonit Ndërkufitar*. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në vlerësimin e trashëgimisë kulturore në rajonin e Bjeshkëve të Numuna duke krijuar rrugë dhe shtigje të reja kulturore si produkt dhe ofertë e re turistike në zonën e synuar.



Me qëllim të përmirësimit të kushteve të lokacioneve të trashëgimisë kulturore dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për turistët, ekipi i projektit në Pejë ka finalizuar ndërhyrjet e vogla në infrastrukturë brenda objekteve kulturore përgjatë shtegut. Ndërhyrjet e vogla në infrastrukturë nënkuptuan vendosjen stolave dekorativë, panos në Llozhan dhe totemit në Pazarin e Vjetër që përmbajnë përshkrimet historike të pasurive të trashëgimisë. Për më tepër, Çarshia e Vjetër është pasuruar edhe me inventar dhe tabelë informative në hyrje të Muzeut të Pejës.

Gurët e vjetër të paraqitur nga Gradina (qyteti antik i Pejës) që përfaqësojnë lashtësinë e Pejës, tani janë vendosur në pllakën e betonit të veshur me pllaka qeramike. Për më tepër, ndërhyrjet e vogla në infrastrukturë në Gusinje do të bëhen sapo të përmirësohen kushtet e motit.



Gjithashtu, si pjesë e aktiviteteve të projektit, ekipi i projektit të komunës së Gucisë, më 28 shkurt të vitit 2022 organizoi një seminar në të cilin morën pjesë më shumë se 15 përfaqësues të sektorit të turizmit. Qëllimi i seminarit ishte të theksohet rëndësia e promovimit të potencialeve turistike përmes trashëgimisë së pasur kulturore të komunës së Gucisë dhe pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë mbi praktikën më të mira nga rajoni kur bëhet fjalë për turizmin kulturor.

Ndiqui aktivitetet e projektit në faqen e dedikuar në [Facebook](#).



## U mbajt takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët të projektit

Takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët të projektit, i asistencës teknike për të dy programet ndërkufitare MNE-ALB dhe MNE-KOS, u mbajt në Podgoricë, me datë 27 Janar 2022, ku përfaqësues të strukturave operuese të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës u takuan dhe diskutuan. Konkretisht, takimi u organizua për të diskutuar mbi aktivitetet e zbatuara gjatë vitit 2021 dhe planin e aktiviteteve për vitin 2022, si dhe të prezantohej, diskutohej dhe miratohej Raporti i dytë Vjetor i projektit "Asistenca Teknike për menaxhimin e programit bilateral BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë.



## Ndryshime institucionale në Mal të Zi dhe Shqipëri

Në vijim të procesit të krijimit të Qeverisë së 43-të të Malit të Zi, ndryshime strukturore dhe institucionale priten gjatë muajit Maj 2022. Siç është njoftuar, Zyra për Integrim Europian do bëhet Ministria për Çështjet e Europës dhe do të koordinojë procesin e aderimit në BE dhe koordinimin e fondeve të BE, përfshirë të dy programet BNK, Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë.

Në Shqipëri, në vijim të procesit të riorganizimit, zbatimi i të gjithë asistencës së BE në Republikën e Shqipërisë, do të koordinohet nga Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës, në varësi të Kryeministrit. Kjo, do të përfshijë gjithashtu edhe koordinimin e aktiviteteve lidhur me programin IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri, që në periudhën paraardhëse u zbatua nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



**Montenegro**  
Ministry of European Affairs



**Montenegro**  
Ministry of Finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA SHITËTORE E PROGRAMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDHJES



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo lokalne samouprave  
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA**  
**PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR**  
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Andi ÇEKAJ**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,  
Kosovë

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian